



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI  
854-860/20  
Nr./Br. 24.11.20  
Datë/Datën. 24.11.20  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PRISHTINË - PRISTINA  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.854/20  
860/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “DELTA-CCD”SH.P.K. & “LIMITPROJECT” SH.P.K. & BD TRADE SHPK & DARING” SHPK-Prishtinë, si dhe OE: “Globi” Trans NN & “Trasing Group” SH.P.K-Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik N.N.T “MILAZIM SHALA & BUJAR SHABANI B.I & V-SHALA”SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “NDERTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJERAVE TË ZEZ NË DRENAS – DOBROSHEC -Projekt Dy vjeçarë”, me nr. të prokurimit: 611-20-4770-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gllogoc, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “DELTA-CCD”SH.P.K. & “LIMITPROJECT” SH.P.K. & BD TRADE SHPK & DARING” SHPK-Prishtinë, si dhe GOE “Globi” Trans NN & “Trasing Group” SH.P.K-Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “NDERTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJERAVE TË ZEZ NË DRENAS – DOBROSHEC -Projekt Dy vjeçarë”, me nr. të prokurimit: 611-20-4770-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gllogoc.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “NDERTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJERAVE TË ZEZ NË DRENAS – DOBROSHEC -Projekt Dy vjeçarë”, me nr. të prokurimit: 611-20-4770-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gllogoc dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik “DELTA-CCD”SH.P.K. & “LIMITPROJECT” SH.P.K. & BD TRADE SHPK & DARING” SHPK-Prishtinë, si dhe GOE “Globi” Trans NN & “Trasing Group” SH.P.K-Pejë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “DELTA-CCD”SH.P.K. & “LIMITPROJECT” SH.P.K. & BD TRADE SHPK & DARING” SHPK-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.10.2020 me nr. 854/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “NDERTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJERAVE TË ZEZ NË DRENAS – DOBROSHEC -Projekt Dy vjeçarë”, me nr. të prokurimit: 611-20-4770-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Komuna Gllogoc” duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:1, 7, 59, 60, dhe 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe pika 39 e RRUOPP-së (sipas nenit 69).

Operatori ekonomik ankues GOE “Globi” Trans NN & “Trasing Group” SH.P.K-Pejë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.10.2020 me nr. 860/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “NDERTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJERAVE TË ZEZ NË DRENAS – DOBROSHEC -Projekt Dy vjeçarë”, me nr. të prokurimit: 611-20-4770-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Komuna Gllogoc”, duke pretenduar se:



- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 56, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 27.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 06.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Sqarim hyrës:** AK - Komuna Gllogoc gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit propozim parashtruesit e ankesave kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK, sipas afateve të parapara me LPP.

**Pergjigje ne pretendimet ankimore (Neni 113) “Globi” Trans NN & “Trasing Group” SH.P.K, me nr:**

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Globi” Trans NN & “Trasing Group” SH.P.K, se AK e ka eliminuar me arsyetimin, si në vijim: A. Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë teknike dhe profesionale nga lista e pajisjeve ju mungojnë dy minidampera (keni prezantuar damper) si dhe dokumentacion për të njëjtin; B. Mungon edhe vendimi i gjeodetit; C. Menaxheri i projektit inxhinier i hidros (keni prezantuar inxhinier të ndërtimatisë)”. Arsyeja B dhe C nuk janë arsye për eliminim por nuk është përmbushur pika A”.

Më tej, OE ankues shton se arsyet e AK-së për eliminimin janë të pa bazuar për arsyet se ne jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit, pasi që tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 kërkesë ka qenë “Të paraqitën paisjet raportet për mjetet - stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) Tre eskavator gjermues dhe ngarkues min 18 t.; Pesë kamion transporti të materialit të kapacitetit min 10 ton; , Dy Mini Damper ,Një Bulduzher ,marveshjen për furnizim me zhavore ,Marveshje për furnizim gypa te betonit, Një makin hidraulike për shpim ,Një pompë për largimin e ujerave nga kanali ,Makinë për ngjeshjen e kanalit”, ndërsa si dëshmi është kërkuar “Lista e pajisjeve – te skanuara nga origjinali për të gjitha kërkesat rreth pajisjeve d te jene te skanuara nga origjinali ) që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre (qera), duhet të ofrohen dëshmitë në kopje (kopjet e librezave ose fatura ose DUD-i - njërën prej tyre duhet marrëveshjet për furnizimet e kerkuara - te skanuara nga origjinali”. Pra, në kërkesën e lartcekur shihet qartë se AK-ja nuk e ka përcaktuar fare

tonazhën e damperit, andaj ne nuk mund dhe nuk duhet të eliminohe mi nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cila nuk është e përcaktuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë. Nëse AK-ja do ta kishte cekur tonazhën ne do ta ofronim pajisjen sipas kërkesës së AK-së, ashtu siç kemi vepruar edhe tani sipas kërkesës së AK-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional 9.1 & 9.2 AK ka kërkuar:

b) Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) Tre eskavator gërmues dhe ngarkues min 18 t.; Pesë kamion transporti të materialit të kapacitetit min 10 ton; , Dy Mini Damper, Një Bulduzher ,marveshjen per furnizim me zhavore ,Marveshje per furnizim gypa te betonit ,Nje makin hidraulike per shpim ,Nje pomp per largimin e ujrave nga kanali ,Makine për ngjeshjen e kanalit

Dëshmia e kërkuar dokumentare

2. Lista e paisjeve - te skanuara nga origjinali për të gjitha kërkesat rreth paisjeve d te jene te skanuara nga origjinali ) që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre (qera), duhet të ofrohen dëshmitë në kopje (kopjet e librezave ose fatura ose DUD-i-njeren prej tyre duhet marreveshjet per furnizimet e kerkuara -te skanuara nga origjinali .

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka prezantuar një listë me pajisje, ku në pozicionin numër rendor 13 është prezantuar Damper, tipi Volvo A25D, prodhuesi Suedi dhe në pozicionin 14 është prezantuar Damper, tipi Damper 22B, prodhuesi Serbi. Gjithashtu, ka bashkangjitur edhe dokumentin unik doganor për këto dy mjete. Kurse, si dëshmi dokumentare ka prezantuar DUD-at doganor, si dhe fotografitë e këtyre dy damperëve.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se AK nuk e ka përcaktuar fare tonazhën e damperit tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional për këto dy mjete, eksperti shqyrtues sqaron se AK nuk ka përcaktuar tonazhën e këtyre dy mjeteve por ka kërkuar (Dy Mini Damper), që për mendimin e eksperti mjetei “Dumper” është një mjet i madh, kurse mjetei “Mini Dumper” është një mjet me përmasa më të vogla se “Dumperi” dhe shumë më i lehtë për të manipuluar në rrugica dhe rrugë të ngushta. Po ashtu, në bazë të hulumtimit në internet rezulton se nese kërkohet mjete me fjalën “Dumper” paraqitet një kamion i përmasave të mëdha, kurse nëse kërkon me fjalën “Mini Dumper” paraqitet një mjet me përmasa shumë më të vogla. Rrjedhimisht, ekziston dallim shumë i qartë i Dumperit dhe Mini Dumperit.

Po ashtu, eksperti shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional 9.1 & 9.2 AK ka kërkuar: a)Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. Stafi i mesëm që do të kyqet në projekt – minimum 10 punonjës, Menaxheri i projektit të jetë inxhinier apo bachelor i



ndertimtaris drejtimi HIDROS me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 3 vjet , CVI-ja) dhe një inxh. Gjeodet bachelor me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 2 vjet - CVI-ja)

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1.Lista e stafit – te skanuar nga origjinali Për të gjitha kërkesat rreth stafit të mesem duhet të ofrohen dëshmitë kontratat kopje, për stafin profesional (inxhinierin e ndertimtaris ) kontrata ose marrëveshja paraprake për angazhimin e Tijë në këtë projekt, kopja e Diplomës , CVI-ja deshmia.

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka prezantuar gjeodetin z. Fadil Shehu, ku i njëjti posedon kualifikimin arsimor sipas kërkesës së FDT-së, ka para kontrata (kontratë në vepër) me OE ankues “Trasing Group” SH.P.K për angazhim për gjitha projektet e vitit 2020. Kjo kontratë është e vulosur nga dy palët dhe mbanë datën 01.04.2020, ka përvojë pune dhe CV. Mirëpo, duke pasur parasysh që për këtë pikë AK për gjeodetin ka kërkuar: “një inxh. Gjeodet bachelor me diplomë i caktuar me një vendim...”, eksperti shqyrtues sqaron se edhe vet AK në kërkesën për rishqyrtim e ka pranuar që kjo pikë nuk është arsye për eliminim por nuk është përmbushur pika A (që ka të bëjë me mini dumper).

Ndërsa, lidhur me pikën tjetër të eliminimit të OE ankues, se menaxheri i projektit inxhinier i hidros (keni prezantuar inxhinier të ndërtimtarisë)”, eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka prezantuar menaxher të projektit z. Agim Gjoshin me kualifikim shkollor inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë u ka mbaruar studimet me 26 mars 1978, ka kontrata pune me OE ankues “Trasing Group” SH.P.K kjo kontratë është e vulosur nga dy palët dhe mbanë datën 06.01.2020, ka përvojë pune dhe CV. Mirëpo, duke pasur parasysh që për këtë pikë AK për menaxherin e projektit ka kërkuar: “Menaxheri i projektit të jetë inxhinier apo bachelor i ndertimtaris drejtimi HIDROS me diplomë i caktuar me një vendim..)”, eksperti shqyrtues sqaron se edhe për këtë pikë vet AK në kërkesën për rishqyrtim e ka pranuar që kjo pikë nuk është arsye për eliminim por nuk është përmbushur pika A (që ka të bëjë me mini dumper).

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Globi” Trans NN & “Trasing Group” SH.P.K, se në njërën nga kontratat tona të nënshkruara me AK përkatësisht kontrata për aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Poklek i Vjetër, Poklek i Ri dhe Vasilevë; Zabel i Uiët, Zabel i Epërm dhe Korroticë e Epërme dhe Korreticë e ulët; Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulët-Projekt dy vjeçar”, me nr. të prokurimit: 611-20-4539-5-2-1, ku për këtë aktivitet ne kemi nënshkruar kontratë edhe pse kërkesa në lidhje me damperin ka qenë e njëjta dhe ne kemi ofertuar me të njëjtën pajisje, mirëpo në projektin e lartcekur ne kemi nënshkruar kontratë, ndërsa tani në këtë aktivitet të prokurimit jemi eliminuar edhe pse i kemi prezantuar pajisjet e njëjta sikurse ne aktivitetin e lartcekur.

Eksperti shqyrtues për këtë pretendim të OE ankues sqaron se nuk e ka trajtuar aktivitetin e prokurimit për të cilin e potencon OE ankues, ku eksperti nuk e din se çfarë kanë qenë kërkesat e dosjes së tenderit për atë aktivitet të prokurimit, eksperti nuk e din se çfarë ka në shkresat tjera për atë aktivitet të prokurimit, si dhe nuk e ka trajtuar atë lëndë. Pra, eksperti nuk mund të deklarohej për një aktivitet tjetër të cilin nuk e ka shqyrtuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku potencon se pajtohem me arsyet e AK-së për eliminimin OE IBRAHIM KURRUMELI B.I. & VALDRINI SH.P.K. & ASFALT GROUP SH.P.K. Eksperti shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit OE "IBRAHIM KURRUMELI B.I. & VALDRINI SH.P.K. & ASFALT GROUP" SH.P.K është eliminuar, ku arsyet e eliminimit të këtij grupi të operatorëve ekonomik janë të përshkruara në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 13.10.2020. Konkretisht i njejt OE nuk e ka kontestuar eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit dhe trajtimi i pretendimeve ankimore të të njëjtit OE është i pa nevojshëm.

Përgjigje ne pretendimet ankimore (Neni 113) të OE "DELTA-CCD"SH.P.K. & "LIMITPROJECT" SH.P.K. & "BD TRADE SHPK & DARING" SHPK

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së për shkak se ka shkelur kriteret e caktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues. Pastaj, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 sepse nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë me konkurrentët, pasi që ne kemi prezantuar dhe plotësuar të gjitha kriteret ndërsa kompanitë konkurrencte me mangësi në plotësim janë konsideruar si të përgjegjshëm. Dëshmitë e mangësive janë prezantuar në vijim.

Eksperti shqyrtues sqaron se qëllimi i nenit 7 të LPP-së është që autoritetet kontraktuese ti trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomik, duke mos favorizuar apo diskriminuar ndonjërin prej operatorëve ekonomik. Në rastin konkret, eksperti shqyrtues konsideron se nuk ka ndodh favorizimi apo diskriminimi i ndonjërit prej OE-ve.

Sa i përket pretendimit që ka të bëjë me nenin 59 të LPP-së, ku OE ankues pretendon se OE "Milazim Shala & Bageri&V-SHALA si dhe 2) grupi i OE FLAMURI V SH.P.K. & N.T. FLAMURI & N.N.P. BISLIMI " janë shpallur të përgjegjshëm edhe pse me mangësi janë vlerësuar të përgjegjshme. Më tej, OE ankues shton se ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, ku AK ka shpallur fitues një grup të OE si të përgjegjshëm edhe pse nuk ka prezantuar CV-në e inxhinierit për projekt menaxher të kontratës Pajtim Vojvoda, ku sipas CV-së - menaxher i kontratë ka vetëm 32 muaj eksperiencë dhe jo 36 muaj (3 vjet sipas kërkesës së dosjes së tenderit në FDT - pika 9.1 & 9.2 dhe ajo përvojë e prezantuar nuk është relevante. Po ashtu, OE ankues pretendon se gjeodeti i prezantuar nuk i përmbushë kriteret e përvojës në CV dhe nuk ka referenca, pas diplomimit si bachelor ose si master, pasi që nuk ka prezantuar projektet në punë të



ngjashme si gjeodet. Si dhe titullin e fituar si diploma sipas CV quhet ekspert për vlerësimin e patundshmërive.

Eksperti shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional 9.1 & 9.2 AK ka kërkuar:

a) Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. Stafi i mesëm që do të kyqet në projekt – minimum 10 punonjës, Menaxheri i projektit të jetë inxhinier apo bachelor i ndertimtaris drejtimi HIDROS me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 3 vjet , CVI-ja) dhe një inxh. Gjeodet bachelor me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 2 vjet - CVI-ja)

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Lista e stafit – te skanuar nga origjinali Për të gjitha kërkesat rreth stafit të mesëm duhet të ofrohen dëshmitë kontratat kopje, për stafin profesional (inxhinierin e ndertimtaris ) kontrata ose marrëveshja paraprake për angazhimin e Tijë në këtë projekt, kopja e Diplomës , CVI-ja deshmia.

Lidhur me kërkesën e AK që inxhinieri “provoja min 3 vjet” dhe pretendimin e OE ankues se menaxheri i projektit të OE të rekomanduar ka vetëm 32 muaj përvojë, eksperti shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që në CV e z.Pajtim Vojvoda është përfshirë kjo përvojë e punës: N.N.T “M.Shala” nga data 06/2016-09/2016, “CDI” nga data 05/2018-06/2019 dhe N.N.T “M.Shala” nga data 06/2019-vazhdon”. Pra, eksperti shqyrtues pas llogaritjes së përvojës së inxhinierit, rezulton se i njëjti ka përvojë 33 muaj. Andaj, i njëjti nuk e plotëson kërkesën e AK-së.

Provë: Pjesë e shkëputur e nga CV-ja

Lidhur me pretendimin e OE ankues kundjet ofertës së OE FLAMURIV SH.P.K. & N.T. FLAMURI & N.N.P. BISLIMI se nuk i plotësojnë kërkesat e AK-së .

Eksperti shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit OE FLAMURIV SH.P.K. & N.T. FLAMURI & N.N.P. BISLIMI është eliminuar, ku arsyet e eliminimit të këtij grupi të operatorëve ekonomik janë të përshkruara në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 13.10.2020. Konkretisht i njëjti OE nuk e ka kontestuar eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit dhe trajtimi i pretendimeve ankimore të të njetit OE është i pa nenvojshem.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e OE ankues se gjedoeti nuk i përmbushë kriteret e përvojës në CV dhe nuk ka referenca, eksperti shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh kërkesën e AK-së “një inxh. Gjeodet bachelor me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 2 vjet - CVI-ja), për mendimin e ekspertit i njëjti e plotëson kërkesën e AK dhe se në FDT në njoftimin për kontratë nuk janë kërkuar referenca siç pretendon OE ankues.

Kurse, sa i përket pretendimit që ka të bëjë me marrëveshjen e gypave të betonit, furnizuesi në certifikatën e vet nga ARBK nuk e ka të regjistruar aktivitetin për prodhimin e produkteve të betonit, por vetëm për fibra të cimentos kodi 2365 dhe 2363-prodhim i betonit të gatshëm për përdorim dhe 2364 prodhim i llaqeve.

Eksperti shqyrtues sqaron se çështja e kodeve apo përshkrimi i aktiviteteve të veprimtarisë së kompanive në certifikatën e regjistrimit të biznesit është çështje teknike pranë ARBK-së. Pra, bizneset në Republikën e Kosovës mund të ushtrojnë çdo veprimtari të ligjshme dhe nuk mund të kufizohen vetëm në kodet që i posedojnë në certifikatë përderisa tenderët apo ofertat e operatorëve ekonomik janë konform kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Përgjatë, kur për veprimtari të caktuara kërkohen leje të veçanta.

Përfundimisht, sipas asaj që u përshkrua si më lartë vlerësimi ynë është se AK, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj propozimi ynë për AK, është që përmes ri vlerësimit të ofertave ti aplikoi në tërësi dispozitat e LPP-së, në mënyrë që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të dosjes së tenderit.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport, propozimi ynë është që ankesat e OE ankues të aprovohen pjesërisht si të bazuara, propozimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në **Ri vlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, Nuk ka dhënë përgjigje.

Operatoret Ekonomik , Nuk kanë dhënë përgjigje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Globi" Trans NN & "Trasing Group" SH.P.K, se AK e ka eliminuar me arsyetimin, si në vijim: A. Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë teknike dhe



profesionale-nga lista e pajisjeve ju mungojnë dy minidampera (keni prezantuar damper) si dhe dokumentacion për të njëjtin; B. Mungon edhe vendimi i gjeodetit; C. Menaxheri i projektit inxhinier i hidros (keni prezantuar inxhinier të ndërtimatisë)”. Arsyeja B dhe C nuk janë arsye për eliminim por nuk është përmbushur pika A”. Më tej, OE ankues shton se arsyet e AK-së për eliminimin janë të pa bazuar për arsyet se ne jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit, pasi që tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 kërkesë ka qenë “Të paraqitën paisjet raportet për mjetet - stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) Tre eskavator gjermues dhe ngarkues min 18 t.; Pesë kamion transporti të materialit të kapacitetit min 10 ton; , Dy Mini Damper ,Një Bulduzher ,marveshjen për furnizim me zhavore ,Marveshje për furnizim gypa te betonit, Një makin hidraulike për shpim ,Një pompë për largimin e ujerave nga kanali, Makine për ngjeshjen e kanalit”, ndërsa si dëshmi është kërkuar “Lista e pajisjeve – te skanuara nga origjinali për të gjitha kërkesat rreth pajisjeve d te jene te skanuara nga origjinali ) që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre (qera), duhet të ofrohen dëshmitë në kopje (kopjet e librezave ose fatura ose DUD-i - njërën prej tyre duhet marrëveshjet për furnizimet e kerkuara -te skanuara nga origjinali”. Pra, në kërkesën e lartcekur shihet qartë se AK-ja nuk e ka përcaktuar fare tonazhën e damperit, andaj ne nuk mund dhe nuk duhet të eliminohe mi nga ky aktivitet i prokurimit për një kërkesë e cila nuk është e përcaktuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë. Nëse AK-ja do ta kishte cekur tonazhën ne do ta ofronim pajisjen sipas kërkesës së AK-së, ashtu siç kemi vepruar edhe tani sipas kërkesës së AK-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetin teknik dhe profesional 9.1 & 9.2 AK ka kërkuar: b) Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) Tre eskavator gjermues dhe ngarkues min 18 t.; Pesë kamion transporti të materialit të kapacitetit min 10 ton; , Dy Mini Damper,Një Bulduzher ,marveshjen per furnizim me zhavore ,Marveshje për furnizim gypa te betonit ,Një makin hidraulike për shpim ,Nje pomp per largimin e ujrave nga kanali ,Makine për ngjeshjen e kanalit, Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Lista e paisjeve - te skanuara nga origjinali për të gjitha kërkesat rreth paisjeve d te jene te skanuara nga origjinali ) që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytezimin e tyre (qera), duhet të ofrohen dëshmitë në kopje (kopjet e librezave ose fatura ose DUD-i-njeren prej tyre duhet marrëveshjet për furnizimet e kerkuara -te skanuara nga origjinali.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka prezantuar një listë me pajisje, ku në pozicionin numër rendor 13 është prezantuar Damper, tipi Volvo A25D, prodhuesi Suedi dhe në pozicionin 14 është prezantuar Damper, tipi Damper 22B, prodhuesi Serbi. Gjithashtu, ka bashkangjitur edhe dokumentin unik doganor për këto dy mjete. Kurse, si dëshmi dokumentare ka prezantuar DUD-at doganor, si dhe fotografitë e këtyre dy damperëve.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se AK nuk e ka përcaktuar fare tonazhën e damperit tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional për këto dy mjete, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK nuk ka përcaktuar tonazhën e këtyre dy mjeteve por ka kërkuar (Dy Mini Damper). Mjeti “Dumper” është një mjet i madh, kurse mjeti “Mini Dumper” është një mjet me përmasa më të vogla se “Dumperi” dhe shumë më i lehtë për të manipuluar në rrugica dhe rrugë të ngushta. Po ashtu, në bazë të hulumtimit në internet rezulton se nëse kërkohet mjeti me fjalën “Dumper” paraqitet një kamion i përmasave të mëdha, kurse nëse kërkon me fjalën “Mini Dumper” paraqitet një mjet me përmasa shumë më të vogla. Rrjedhimisht, ekziston dallim shumë i qartë i Dumperit dhe Mini Dumperit.

Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional 9.1 & 9.2 AK ka kërkuar: a)Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. Stafin profesional. Stafin i mesëm që do të kyqet në projekt – minimum 10 punonjës, Menaxheri i projektit të jetë inxhinier apo bachelor i ndertimtaris drejtimi HIDROS me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 3 vjet , CVI-ja) dhe një inxh. Gjeodet bachelor me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 2 vjet - CVI-ja)

Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Lista e stafit – te skanuar nga origjinali Për të gjitha kërkesat rreth stafit të mesëm duhet të ofrohen dëshmitë kontratat kopje, për stafin profesional (inxhinierin e ndertimtaris ) kontrata ose marrëveshja paraprake për angazhimin e Tijë në këtë projekt, kopja e Diplomës , CVI-ja deshmia.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka prezantuar gjeodetin z. Fadil Shehu, ku i njëjti posedon kualifikimin arsimor sipas kërkesës së FDT-së, ka para kontrata (kontratë në vepër) me OE ankues “Trasing Group” SH.P.K për angazhim për gjitha projektet e vitit 2020. Kjo kontratë është e vulosur nga dy palët dhe mbanë datën 01.04.2020, ka përvojë pune dhe CV. Mirëpo, duke pasur parasysh që për këtë pikë AK për gjeodetin ka kërkuar: “një inxh. Gjeodet bachelor me diplomë i caktuar me një vendim...”, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se edhe vet AK në kërkesën për rishqyrtim e ka pranuar që kjo pikë nuk është arsye për eliminim por nuk është përmbushur pika A (që ka të bëjë me mini dumper).

Ndërsa, lidhur me pikën tjetër të eliminimit të OE ankues, se menaxheri i projektit inxhinier i hidros (keni prezantuar inxhinier të ndertimtarisë)”, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka prezantuar menaxher të projektit z. Agim Gjoshin me kualifikim shkollor inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë u ka mbaruar studimet me 26 mars 1978, ka kontrata pune me OE ankues “Trasing Group” SH.P.K kjo kontratë është e vulosur nga dy palët dhe mbanë datën 06.01.2020, ka përvojë pune dhe CV. Mirëpo, duke pasur parasysh që për këtë pikë AK për menaxherin e



projektit ka kërkuar: “Menaxheri i projektit të jetë inxhinier apo bachelor i ndertimtaris drejtimi HIDROS me diplomë i caktuar me një vendim..)”, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se edhe për këtë pikë vet AK në kërkesën për rishqyrtim e ka pranuar që kjo pikë nuk është arsye për eliminim por nuk është përmbushur pika A (që ka të bëjë me mini dumper).

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Globi” Trans NN & “Trasing Group” SH.P.K, se në njërën nga kontratat tona të nënshkruara me AK përkatësisht kontrata për aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Poklek i Vjetër, Poklek i Ri dhe Vasilevë; Zabel i Uiët, Zabel i Epërm dhe Korroticë e Epërme dhe Korreticë e ulët; Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulët-Projekt dy vjeçar”, me nr. të prokurimit: 611-20-4539-5-2-1, ku për këtë aktivitet ne kemi nënshkruar kontratë edhe pse kërkesa në lidhje me damperin ka qenë e njëjta dhe ne kemi ofertuar me të njëjtën pajisje, mirëpo në projektin e lartcekur ne kemi nënshkruar kontratë, ndërsa tani në këtë aktivitet të prokurimit jemi eliminuar edhe pse i kemi prezantuar pajisjet e njëjta sikurse ne aktivitetin e lartcekur.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues për këtë pretendim të OE ankues sqaron se nuk e ka trajtuar aktivitetin e prokurimit për të cilin e potencon OE ankues, ku Paneli Shqyrtues konform ekspertit nuk e din se çfarë kanë qenë kërkesat e dosjes së tenderit për atë aktivitet të prokurimit, si dhe nuk e din se çfarë ka në shkresat tjera për atë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku potencon se pajtohem me arsyet e AK-së për eliminimin OE IBRAHIM KURRUMELI B.I. & VALDRINI SH.P.K & ASFALT GROUP SH.P.K.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit OE “IBRAHIM KURRUMELI B.I. & VALDRINI SH.P.K & ASFALT GROUP” SH.P.K është eliminuar, ku arsyet e eliminimit të këtij grupi të operatorëve ekonomik janë të përshkruara në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 13.10.2020. Konkretisht i njëjti OE nuk e ka kontestuar eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit dhe trajtimi i pretendimeve ankimore të njëjtit OE është i pa nevojshëm.

Përgjigje ne pretendimet ankimore (Neni 113) të OE “DELTA-CCD”SH.P.K. & “LIMITPROJECT” SH.P.K. & “BD TRADE SHPK & DARING” SHPK

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së për shkak se ka shkelur kriteret e caktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues. Pastaj, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 sepse nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë me konkurrentët, pasi që ne kemi prezantuar dhe plotësuar të gjitha kriteret ndërsa kompanitë konkurrencte me mangësi në plotësim janë konsideruar si të përgjegjshëm. Dëshmitë e mangësive janë prezantuar në vijim.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se qëllimi i nenit 7 të LPP-së është që autoritetet kontraktuese ti trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomik, duke mos favorizuar apo diskriminuar ndonjërin prej operatorëve ekonomik. Në rastin konkret, nuk ka ndodh favorizimi apo diskriminimi i ndonjërit prej OE-ve.

Sa i përket pretendimit që ka të bëjë me nenin 59 të LPP-së, ku OE ankues pretendon se OE “Milazim Shala & Bageri&V-SHALA si dhe 2) grupi i OE FLAMURI V SH.P.K. & N.T. FLAMURI & N.N.P. BISLIMI ” janë shpallur të përgjegjshëm edhe pse me mangësi janë vlerësuar të përgjegjshme. Më tej, OE ankues shton se ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, ku AK ka shpallur fitues një grup të OE si të përgjegjshëm edhe pse nuk ka prezantuar CV-në e inxhinierit për projekt menaxher të kontratës Pajtim Vojvoda, ku sipas CV-së - menaxher i kontratë ka vetëm 32 muaj eksperiencë dhe jo 36 muaj (3 vjet sipas kërkesës së dosjes së tenderit në FDT - pika 9.1 & 9.2 dhe ajo përvojë e prezantuar nuk është relevante. Po ashtu, OE ankues pretendon se gjeodeti i prezantuar nuk i përmbushë kriteret e përvojës në CV dhe nuk ka referenca, pas diplomimit si bachelor ose si master, pasi që nuk ka prezantuar projektet në punë të ngjashme si gjeodet. Si dhe titullin e fituar si diploma sipas CV quhet ekspert për vlerësimin e patundshmërive.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional 9.1 & 9.2 AK ka kërkuar: a) Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. Stafi i mesëm që do të kyqet në projekt – minimum 10 punonjës, Menaxheri i projektit të jetë inxhinier apo bachelor i ndertimtaris drejtimi HIDROS me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 3 vjet , CVI-ja) dhe një inxh. Gjeodet bachelor me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 2 vjet - CVI-ja)

Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Lista e stafit – te skanuar nga origjinali Për të gjitha kërkesat rreth stafit të mesëm duhet të ofrohen dëshmitë kontratat kopje, për stafin profesional (inxhinierin e ndertimtaris ) kontrata ose marrëveshja paraprake për angazhimin e Tijë në këtë projekt, kopja e Diplomës , CVI-ja dëshmia.

Lidhur me kërkesën e AK që inxhinieri “provoja min 3 vjet” dhe pretendimin e OE ankues se menaxheri i projektit të OE të rekomanduar ka vetëm 32 muaj përvojë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që në CV e z.Pajtim Vojvoda është përfshirë kjo përvojë e punës: N.N.T “M.Shala” nga data 06/2016-09/2016, “CDI” nga data 05/2018-06/2019 dhe N.N.T “M.Shala” nga data 06/2019-vazhdon”. Pra, eksperti shqyrtues pas llogaritjes së përvojës së inxhinierit, rezulton se i njëjti ka përvojë 33 muaj. Andaj, i njëjti nuk e plotëson kërkesën e AK-së.



Lidhur me pretendimin e OE ankues kundjet ofertës së OE FLAMURIV SH.P.K. & N.T. FLAMURI & N.N.P. BISLIMI se nuk i plotësojnë kërkesat e AK-së .

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit OE FLAMURIV SH.P.K. & N.T. FLAMURI & N.N.P. BISLIMI është eliminuar, ku arsyet e eliminimit të këtij grupi të operatorëve ekonomik janë të përshkruara në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 13.10.2020. Konkretisht i njëjti OE nuk e ka kontestuar eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit dhe trajtimi i pretendimeve ankimore të të njëjtit OE është i pa nevojshëm.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e OE ankues se gjeodeti nuk i përmbushë kriteret e përvojës në CV dhe nuk ka referenca, eksperti shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh kërkesën e AK-së “një inxh. Gjeodet bachelor me diplomë i caktuar me një vendim, provoja min 2 vjet - CVI-ja), Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se i njëjti e plotëson kërkesën e AK dhe se në FDT në njoftimin për kontratë nuk janë kërkuar referenca siç pretendon OE ankues.

Kurse, sa i përket pretendimit që ka të bëjë me marrëveshjen e gypave të betonit, furnizuesi në certifikatën e vet nga ARBK nuk e ka të regjistruar aktivitetin për prodhimin e produkteve të betonit, por vetëm për fibra të cimentos kodi 2365 dhe 2363-prodhim i betonit të gatshëm për përdorim dhe 2364 prodhim i llaqeve.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se çështja e kodeve apo përshkrimi i aktiviteteve të veprimtarisë së kompanive në certifikatën e regjistrimit të biznesit është çështje teknike pranë ARBK-së. Pra, bizneset në Republikën e Kosovës mund të ushtrojnë çdo veprimtari të ligjshme dhe nuk mund të kufizohen vetëm në kodet që i posedojnë në certifikatë përderisa tenderët apo ofertat e operatorëve ekonomik janë konform kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Përjashtimit, kur për veprimtari të caktuara kërkohen leje të veçanta apo edhe kur AK ka kërkesë në dosje të tenderit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit nuk ka pasur parasysh kërkesat e dosjes së tenderit. Andaj, obligohet AK që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së në mënyrë që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të dosjes së tenderit, Obligohet AK që konform nenit 59 dhe 72 të kërkojë sqarime apo plotësime nga operatorët duke filluar nga me i liri pasi që autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK – “Komuna Gllogoc”;

1x1 OE -“DELTA-CCD”SH.P.K. & “LIMITPROJECT” SH.P.K. & BD TRADE SHPK & DARING” SHPK;

1x1 OE “Globi” Trans NN & “Trasing Group” SH.P.K;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.